

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI

"XHELAL HAJDA-TONI"

1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Xhelal Hajda - Toni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësuesve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



Jam 17 vjeç, jam shumë e re, por kam parë tepër shumë të ndodhë në mjedisin tonë, në aspektin negativ, kam parë njerëz tek flasin për mbrojtjen e mjedisit e pastaj menjëherë pas fjalimit të pinë ujë në shishe plastike dhe kur e zbraznin e hidhnin në rrugë ata dhe çdo njeri tjetër, pa pikë dhembje!

Nuk e besoj se ata e dinin se ta keqtrajtojnë mjedisin është më keq se të keqtrajtojnë nënën tënde, ngase këto dyja dallojnë veç nga pamja e lidhja jonë me to, e si ta dije një person vlerën e natyrës përderisa nuk e din se çdo gjë kthehet dhe nëse jo për të, do bëhet shkas i problemeve shëndetësore të fëmijut të tij.

Kam parë tek flitet për pasurinë materiale e të harrohet pasuria e vërtetë, e mirënjohja të mos ekzistojë, kam parë shumë, por asnjëherë një njeri tek falenderohet për faktin se jeton në një natyrë kaq perfekte, e qka pashë ishte pikërisht ky person të ndotë atë!

Gjendja është e rëndë, duhet bërë diçka që edhe pse pak do ndikojë në përmirësimin e nënës natyrë, qoftë edhe në një zonë shumë të vogël.

Mjedisi ynë po vuan dhe ne jemi shkaktarët e kësaj vuajtje dhe bartësit e pasojave.

**O NJERËZ NUK E BËNI PËR ASKËND TJETËR POS VETES,
QOFTË NDOTJEN QOFTË PASTRIMIN.**

ELONA SPAHIU – EKO KLUBI "XHELAL HAJDA - TONI"

EDUKIMI MJEDISOR PËRMES ARTIT




FILM NEGATIVE



FILM NEGATIVE



FILM NEGATIVE




FILM NEGATIVE

FILM NEGATIVE




MBAJTJA E LIGJERATAVE VETDIJËSUESE PËR NXËNËSITË E SHKOLLËS "XHELAL-HAJDA-TONI" BLERTA ORUÇI – ADEA EJUPI






AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
ËC MA NDRYSHE





AKSION PASTRIMI NË OBORRIN E SHKOLLËS



EKO KLUBI "XHELAL HAJDA - TONI"

RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".